



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:052360
Datë: 26.01.2024
Numri i dokumentit: 05247341

A.nr.463/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditëses M.. Sh.. nga fshati Sh., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E..A., avokat nga P., kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë, për shkak të anulimit të vendimit Nr.02-247 të datës 21.02.2023, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 17.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses M.. Sh.. nga fshati Sh., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E.. A., avokat nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.02-247 i datës 21.02.2023 i të paditurës Ministria e Drejtësisë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja me padinë e datës 28.02.2023 ka kërkuar anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi. Përmes padisë pohon se vendimi i kontestuar është rrjedhojë e konstatimit të gabuar të gjendjes faktike për shkak të gjitha arsyeve për të cilat radhazi paditësja i ka paraqitur në mënyrë të drejtë në ankesë, të cilat e vënë në dyshim të plotë ligjshmërinë e vendimit kontestues. I propozon gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin e aprovon padinë e paditësit dhe e anulon vendimin e kundërshtuar me padi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditëses deklaroi: *“Mbesim pranë padisë , sa i përket përgjigjes në padi lidhur me padinë e paditëses, paditësja personalisht dhe i autorizuari i saj në formë*

të shkruar kanë paraqitur sqarime faktike dhe juridike përkitazi pretendimeve të cilat janë paraqitur në përgjigje në padi të së paditurës , për çka gjykatës në këtë seancë ia dorëzojmë në formë të shkruar edhe për palën e paditur, po ashtu gjykatës në cilësi të provës materiale ia dorëzoj edhe komunikimin elektronik në të cilën kam paraqitur kundërshtimet e mia si dhe agjendën e rendit të ditës për dt.11.11.2022”. Ndërkaq në deklarinimin e dorëzuar në formë të shkruar deklaroi: “Pretendimet e mia lidhur me shkeljet e komisionit përzgjedhës të kandidatëve për anëtarë të: Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, në aplikimin e datës 20.04.2022 janë të bazuara, andaj komisioni shqyrtues AD-HOC i Ministrisë së Drejtësisë ka bërë vertetim të gabuar në ankesën e parashtruar më 30.01.2023, në raport me ankimimit për mos përzgjedhje për anëtarë e KPSHSF. Në njoftimin selektivë, njëanshëm (vetëm) për kandidatët e përzgjedhur për anëtarë të KPSHSF nga Ministria e Drejtësisë më 26.01.2023, në raport me konkursin e muajit/Prill 2022 shpallur nga Ministria e Financave Punes dhe Transfereve. Kërkesa për anëtarë e KPSHSF aplikuar më 20.04.2022 është parashtruar në kohë dhe në përputhje me UA 06/2017 Për Plotësim Ndryshimin e UA Nr. 10/2012 Për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funkcionimin e Këshillit për Shërbime Sociale dhe anëtarëve të këshillit, pikën 1, nënpika 1.1 citoj: Të ketë përgaditje adekuate sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përparësi me kualifikim më të lartë akademik. Shif dosjen e aplikimit: Diploma Magjistër i shkencave Juridike, kualifikim më i lartë akademik se fakulteti. II. Sipas nenin 4 kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit, bazuar në pikën 1, nënpika 1.1 -1.6, veqanarisht pika 1.1 1.5 (përparësi kualifikimi më i lartë akademik. Kandidatët që ofrojnë dëshmi se kanë ofruar përvojë, ekspertiza nga lëmia e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe kanë publikime shkencore nga po e njejta lëmi. Kushte dhe kriteret këto të plotësuara sipas nënpikës 1.1 1.5 të UA, në përparësi për antarë të KPSHSF, aplikacioni me dokumente si në vijim: Diploma e përgaditjes më të lartë: Magjister i Shkencave Juridike, Nr. 238/13 me 27.06.2012, kualifikim më i lartë akademik se fakulteti. Certifikata e Fakultetit Filozofik (Profesor i Pedagogjisë) nr.5937/206 të datës 02.04.2001, lëshuar në vend Diplome, Certifikata: Bachelor në Punën Sociale, lëshuar më 26 qeshor 2006 noterizuar 08.04.2022, nëshkruar nga UP dhe Univerziteti i Helsinkut, përgaditje akademike e njohur ndërkombtarisht 2004-2006 (shif certifikatat në lëndë të noterizuara 2004-2006), Certifikatë Licensimi me Nr. Licensës: 31/20R, dt. 17.06.2020 (Licensuar 12.06.2020 deri 11.06.2023, Vendimi i vazhdimit të licensës për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare Nr. 43, dt. 12.06.2020, certifikata Nr. 07-38/182 datës 15.10.2012 me temën e mbrojtjes së masterit: Delikuenca e të Miturëve në Kosovë 2005-2010 (punim shkencor), Kontrata nga KPSHSF për trajnere Nr. 57, dt. 28.02.2022. Ndjekja e pesë kurseve në kohëzgjatja; një muaj për secilin kurs, organizuara në nivel rajoni nga NALAS. Giz, përfshirë: R. Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë, e vetmja pjesmarrëse nga R. Kosovës në kuadër të shërbimeve sociale, realizuar me suksese të shkelqyeshëm. Sif. Certifikatat: Shërbimet e Kujdest Ditor në Nivel Lokla, 6 prill-4 maj 2021, shërbimet Mobile në Komunitet, 4 maj -1 qershor 2021, Dialogu Social 18maj-15 maj 2021, Inclusive Disaster Risk Menagment 6 shtator -03 tetor 2021, Komisionieri i Minoriteteve 13shtator-18 tetor 2021, Vertetimi për përvojen e punës Nr. 04/2022 dt. 07.02.2022 (Përvojë 20 vite në shërbime Sociale dhe familjare), Vertetimet nga partnerët vendor e ndërkombëtar (referencë për KPSHSF nga The Ideas Partnership, CRPK,DSHPS, POLIS). III. Petendimet e komisionit vlerësues përzgjedhës të kandidatëve për KPSHSF dhe e organi shqyrtues në rrugë administrative (Komisioni AD-HOC) në MD. Kanë qenë subjektive dhe jo profesionale, për faktin se kanë rënë në kundërshtim me legjitimitetin e dhënë si ofruese e shërbimeve sociale me licensë, mbi pëgaditjen profesionale dhe përvojen e punës, në diskualifikimin e një pofesioniste të investuar maksimalisht (sipas pikës 4, nënpikës 1.1,1.5, të UA 06/2017 Për Plotësim Ndryshimin e UA Nr.

10/2012 Për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funkcionimin e Këshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

IV. Pretendimet e komisionit AD- HOC sipas Vendimit Nr. 02-247 dt. 21.02.2023 nga MD se nuk kam ofruar dëshmi shtesë sipas e-mailit të datës 13.06.2022 kopjen e diplomës të noterizuar, janë të pa bazuara, sepse unë kam kthyer përgjegje me 14.06.2023. Jam në një rrethane post-mortore, por certifikata është në vend të diplomës, pasi që në atë mënyrë janë lëshuar kur kam diplomuar, (Certifikaten e Fakultetit Filozofik (Profesor i Pedagogjisë) nr.5937/206 të datës 02.04.2001. e cila është lëshuar në vend Diplome) pastaj në dosje kenë edhe masterin me diploma të noterizuar që legjitimon avansimin akademik pas diplomimit në fakultet.

V. Pretendimet e miya nuk janë vetëm në shkeljet e mos përzgjedhjes time si anëtare e KPSHSF, sipas kushteve të plotësuar maksimalisht, por edhe rreth legjitimitetit të Komisionit për përzgjedhjen e antarëve të Këshillit të përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare, pasi që komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të kandidatëve për antarë të këshillit të përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare, sipas Vendimit Nr. 1114/2022 të datës 25.05.2022 DPSF/MFPT pa kompetence profesionale, pasi që kryesuesi nuk vie nga Divizioni i Shërbimeve Sociale (ku edhe është regjistri i profesionistëve në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare të Ministrisë të Financave Punës dhe Transfereve.

Kontesuese është për KPSHSF, pasi që konkursi dhe emrimi i komisionit vlerësues është bërë nga MFPT 04/2022, ndërsa vendimi për përzgjedhës të antarëve të këshillit është marrë nga një Ministri tjetër, nga MD pas një periudhe gjashtë mujore 01/2023 në diferencë 04.2022-01.2023. Ku edhe dokumentacionit në kuadër të kriterëve konsiderohet jo valid dhe i pa afatshëm.

Aplikim i gabuar në njoftim sipas Ligjit nr. 05/L-31 të procedurës së përgjithshme administrative e drejta aplikimit për të u informuar me kohë me vendim apo akt administrativë, aplikim i njëanshem i njoftimit vetëm për kandidatët e pranuar, jo në agat për shkak të skadimit të validitetit të dokumentacionit në kuadër të kriterëve, pasi që disa nga dokumentat nuk kanë validitet mbi gjashtë muaj siç është (dëshmia e punës, marrëdhënia e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime, etj.) Ajo qfar është më shqetësuese mandati i KPSHSF ka përfunduar në Mars/2022, dhe Ri- konstituimi i këshillit ka ndodhur më 26.01.2023, ndërsa në emër të KPSHS janë zhvilluar aktivitete për akreditim të moduleve, për çka jemi ftuar edhe ne. Sipas nën pikës 2.1 të pikës 4 UA 06/2017, pretendimet e mia lidhur me shkeljet e komisionit përzgjedhës të kandidateve për antarë të: Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, në aplikimin e datës 20.04.2022 janë të bazuara, andaj komisioni shqyrtyes AD-HOC i Ministrisë së Drejtësisë ka bërë vertetim të gabuar në ankesën e parashtruar 30.01.2023, për faktin që antarët e KPSHSF duhet të kenë përvojë jo nga marrëdhënia e punës, por nga shërbimet sociale dhe familjare. Mundësisht si profesionist të jenë nga departamenti i linjës apo ministria përkatëse. Si përfundim Përmes kësaj parashtrëse konsiderojë se diskualifikimi jo ligjor për anëtare të KPSHSF, ka vënë në pah shkeljet e komisionit përzgjedhës të kandidatëve për KPSHSF, dhe vet konstituimin e KPSHF, andaj legjitimiteti i këshillit duhet provuar në këtë parashtrësë, njëkohësisht kërkoj kthim të integritetit tim profesional duke anuluar vendimin Nr. 02/247 I dt. 21.02.223 si jo ligjor”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, deklaroi: “Sqaroj se me provat të cilat u administruan u vërtetua bindshëm se vendimi kontestues i të paditurës është jo ligjor për të gjitha shkaqet dhe arsyet si dhe pretendimet të cilat janë paraqitur në ankesën e paditëses dhe në përmbajtje të provave të shqyrtuara

rrjedh se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar , andaj gjykatës i propozojmë që si e tillë të miratohet”.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 31.07.2023, e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar ndër të tjera se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare. Andaj, e paditura, i propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me numër protokollit 02-247 i dt.21.02.2023, ankesa e dt.30.01.2023, kërkesa e dt.20.04.2022, CV e paditëses, diploma universitare e nivelit mister e dt.27.06.2012, vërtetimi i provimeve të dhëna i dt.15.10.2012, certifikata nga Fakulteti Filozofik i U.P Prishtina dt.02.04.2001, certifikata e lëshuara nga institucionet e ndryshme për përfundim të trajnimeve të ndryshme, vërtetimi nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Lipjanit dt.07.02.2022, certifikata e licencimit dt.17.06.2020, vendimi i dt.12.06.2020, letër rekomandimet e dt.15.04.2022, 20.04.2022 dhe 14.04.2022, kontrata nr.57 dt.28.02.2022, certifikata penale e dt.12.04.2022, raporti i dt.27.06.2022, kërkesa për shpallje të konkursit dt.18.03.2022, konkursi i dt.07.04.2022, kërkesa e dt.26.04.2022, vendimi me numër 180/22 dt.24.05.2022, njoftimi i dt.27.06.2022, komunikimi elektronik dt.14.06.2022, vendimi i dt.07.02.2023, komunikimi elektronik në të cilën kam paraqitur kundërshtimet e mia si dhe agjendën e rendit të ditës për dt.11.11.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi si dhe propozimin e paditëses për anulimin e të njëjtit, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se i padituri drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e shqyrtimit dhe refuzimit të ankesës së paditëses.

Gjykata konstatoi se procedura administrative e zhvilluar tek i padituri është kryer në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata poashtu gjeti se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe me të drejtë janë trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit.

Gjykata vlerësoi aspektin formal të vendimit të atakuar me padi dhe gjeti se i njëjti është në përputhje të plotë me nenin 47 të LPPA-së, ku përcaktohet: *“Neni 47-Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar*

1. Akti administrativ i shkruar përmban:

1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;

1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.

1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrative apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin e mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht të kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjial. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruan një nga anëtarët e organit kolegjial.

3. Kërkesa e nënshkrimit, sipas paragrafit 2 të këtij neni, në rastin e një dokumenti elektronik, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm. Nënshkrimi elektronik duhet të bazohet në një certifikatë të kualifikuar, në të cilën shprehet identiteti i organit publik përkatës.

4. Qeveria e Republikës të Kosovës, me vendim të posaçëm, mund të përcaktojë një mënyrë tjetër të sigurt, që garanton autenticitetin dhe integritetin e dokumentit elektronik të dërguar dhe veçantitë e tij. Një dokument elektronik i garantuar në pajtim me një vendim të tillë të Qeverisë, do të vlerësohet, gjithashtu, si i nënshkruar”.

Gjykata gjeti se paditësja kishte aplikuar për tu zgjedhur anëtare e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare nga regjistri i profesionistëve. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se paditësja me rastin e aplikimit në këtë pozitë nuk i kishte bashkëngjitur dokumentacionin përkatës sipas obligimit ligjor dhe kushteve e kriterëve të përcaktuara në konkursin e datës 07.04.2022. Gjykata gjeti se e njëjta me të drejtë ishte kontaktuar përmes telefonit nga ana e të paditurës, e cila poashtu i kishte dhënë afat shtesë paditëses, e cila në emailin e datës 14.06.2022 kishte pohuar se i ka bashkëngjitur certifikatën në vend të diplomës dhe diplomën e masterit të noterizuar pasi që e ka përfunduar jashtë Republikës së Kosovës. Në lidhje me këtë, gjykata e vlerëson si të drejtë dhe të duhur konstatimin e të paditurës për refuzimin e ankesës të së njëjtës mbi bazën e asaj që paditësja nuk kishte dorëzuar Diplomën e noterizuar, siç ishte kërkuar sipas kriterëve të konkursit.

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se e paditura me të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike mbi bazën e provave të ofruara në procedurën administrative, me të drejtë ka aplikuar të drejtën materiale si dhe me të drejtë ka zbatuar dispozitat e konkursit në fjalë, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësja.

Duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditëses por të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë, as para të paditurit e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj Gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, i padituri drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësja. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.463/2023, datë: 17.01.2024

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.